REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 369
Datë/Dat. 13. 11. 2026

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALI TY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tretë (e jashtëzakonshme) e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 26.09.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Ali Topalli, Rrahim Tërnava, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Ali Ismaili, Driton Ademi dhe Gjelbrim Halili.

Mungojnë: Etnik Berjani dhe Radoman Doderovic.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Shpend Bardiqi - Nënkryetar i Komunës, Vildane Latifi - Drejtoresh e Administratës, Mirsad Qyqalla - Drejtor i Bujqësisëe Zhvillimit Rural, Durim Hajra - Drejtor i Inspektoratit dhe Arianit Tërmkolli - Drejtor i Infrastrukturës.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës së përbashkëtë të Kuvendit të Komunës të Fushë-Kosovës 'JO NË EMRIN TIM', lidhur me Aktgjykimin e Shkallës së Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndaj luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, të nderuar anëtarë të Ekzekutivit të Komunës së Fushë-Kosovës, të nderuar përfaqësues të organiztave të dalura nga lufta, luftëtarë e çlirimtarë, që na nderoni me pjesëmarrjen tuaj, të dashur musafirë dhe ju të pranishëm, po e hapim mbledhjen e tretë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, përmbajtja e saj është shumë e rëndësishme dhe e madhe: Shqyrtimi dhe miratimi i deklaratës së përbashkët të Kuvendit të Komunës së Fushë- Kosovës 'JO NË EMRIN TIM', lidhur me Aktgjykimin e Shkallës së Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndaj luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po e hapi zyrtarisht diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës dhe e ftoj propozuesin të dal dhe ta mbajë qëndrimin e tij para neve, z. Migjen Kolshi, fjala për ju.

Migjen Kolshi: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, Nënkryetar i Komunës, të nderuar përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta, të nderuar/a kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, këtë mbledhje e kemi thirrë me një qëllim të qartë, ku përmes një 'Deklarate të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës 'JO NË EMRIN TIM', lidhur me Aktgjykimin e Shkallës

së Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndaj luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaqi, z. Jakup Krasniqi, z. Kadri Veseli dhe z. Rexhep Selimi, ky Kuvend të dërgohet zëri ynë përballë një aktgjykimi, që ka prekur thellë ndjenjat e qytetarëve tanë dhe raportin tonë për një periudhë më të rëndësishme të historisë tonë. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, ju falenderojë secilin Grup Parlamentarë dhe secilin asambleistë që e ka përkrahur me anë të nënshkrimit dhe ata që janë prezentë në këtë mbledhje. Përkrahja juaj sot dëshmon se përtej dallimeve politike, janë disa çështje që na bashkojnë, tani Ushtria Çlirimtare të Kosovës nuk i përket një partie politike, lufta për liri nuk i përket një partie politike, sakrifica e popullit tonë nuk i përket një partie politike, ajo është pjesa më e rëndësishme e historisë tonë, edhe njëherë ju falenderojë të gjithëve për pjesëmarrjen dhe përkrahjen.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë z. Migjen Kolshi, po vazhdojmë me fjalimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, pastaj përfaqësuesit nga Ekzekutivi i Komunës, Shefat e Grupave Parlamentare, e pas tyre secili që ka diçka për të thënë në këtë mbledhje. Të nderuar/a të pranishëm faleminderit që jeni pjesë e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlera jonë më e madhe kombëtare. Ajo ishte ushtri e pastër, e dalë nga populli, nga populli i pastër, nuk kishte si të ishte ndryshe, përveç se ushtri e pastër. Shtypja sistematike, dhuna e vazhdueshme, planet shtetërore për eliminim, vrasje, dëbim e shfarosje të Serbisë hegjemoniste, e detyruan popullin tonë të organizohen, të bashkohen dhe të luftojnë për mbrojtje, çlirim e liri. Trimat luftëtarë, çlirimtarët tanë, ata që me vetëmohim u rreshtuan për luftë, kundrejt një force të pabarabartë, dolën në mbrojtje të të pambrojturve, të shkelurve, popullit tonë... dhanë kohë, mund, gjak e jetë për lirinë tonë, çlirimin tonë, shtetin tonë. Ata sot, po tentohet të dënohen, pa të drejtë, pa bazë argumenti, me direksione të armikut dhe në emër të kujt? JO NË EMRIN TIM! JO NË EMËR TË POPULLIT TË KOSOVËS! JO NË EMËR TË GJAKUT TË LUFTËTARËVE, DËSHMORËVE, INVALIDËVE! Kjo gjykatë ishte e padrejtë, u themelua si e tillë, u zhvillua si e tillë, burgosi si e tillë, mashtroi si e tillë, dënoi si e tillë. E tillë do të përfundojë, pra e pa drejtë, se nuk është dhe nuk do të ketë sukses padrejtësia ndaj luftës së drejtë e popullit të drejtë! z. Rexhep Selimi, z. Hashim Thaqi, z. Jakup Krasniqi dhe z. Kadri Veseli, në emrin tim ata janë ÇLIRIMTARË, nuk ka gjykatë as tribunal në botë që u'a ndërron këtë epitet, për të cilin ata u sakrifikuan! Andaj ne, të zgjedhurit e popullit, e dënojmë duke mos e pranuar këtë vendim të këtyre Dhomave të Specializuara, të kësaj gjykate me tërë forcën tonë, sepse padrejtësisht po dënohen ata që zgjodhën popullin për mbrojtje, para jetës së tyre. RROFTË USHTRIA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS. Në emër të Ekzekutivit të Komunës ftojmë z. Durim Hajra për fjalë rasti.

Durim Hajra: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, të nderuar/a drejtor/e, përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta, të nderuar të pranishëm, kur një aktgjykim shqiptohet në emër të popullit të Kosovës, qytetarët kanë të drejtë të pyesin, nëse e gjejnë vetën në atë vendim, sot nga kjo sallë ne i japim zë mospajtimit të tyre, që kanë shprehur në sheshe dhe tubime të shumta, tani është radha e Kuvendit të shprehë këtë me përgjegjësinë që i takon një institucioni. Në emër të Ekzekutivit të Komunës së Fushë-Kosovës, deklaroj se e konsiderojmë të padrejtë aktgjykimin ndaj krerëve të Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaqi, z. Kadri Veseli, z. Jakup Krasniqi dhe z. Rexhep Selimi. Mbështesin miratimin e deklaratës 'JO NË EMRIN TIM', si dhe kërkojmë që në procedurën e apelit, provat dhe argumentet të shqyrtohen me paanshmëri, seriozitet dhe drejtësi. Të nderuar të pranishëm ky proces nuk lidhet vetëm me fatin e individëve, ai prekë mënyrën se si vlerësohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila u zhvillua për lirinë e popullit tonë, prekë themelet mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës. Sot ne flasim lirshëm në këtë sallë dhe përfaqësojmë qytetarët, por pas kësaj të drejte qëndrojnë jetë të humbura, familje të shpërngulura dhe njerëz që sakrifikuan gjithë çka për liri. Kërkojmë që kur flitet për luftën e Kosovës, të mos harrohet arsyeja pse njerëzit u detyruan të luftojnë, historia e asaj kohe nuk mund të shkëputet nga rrethanat në të cilat u zhvillua lufta dhe sakrifica e popullit tonë, asnjë fjalë nga kjo foltore nuk mund ta zëvendësojë një vendim të drejtë në apel, megjithatë heshtja jonë do t'i linte qytetarët pa përfaqësim, prandaj po flasim sot për të shprehur pakënaqësinë dhe mospajtimin tonë ndaj këtij aktgjykimi, por edhe për të theksuar besimin se drejtësia, mund të vihet ende në vend. Të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit të Komunës, tani t'i lëjmë me një anë dallimet politike dhe ta trajtojmë këtë deklaratë me peshën dhe përgjegjësinë që meriton, liria që gëzojmë sot, është e fituar me sakrificën e popullit tone, andaj e kemi për detyrë të mbrojmë vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe lirinë që na solli ajo. Sot në shtetin tonë jetojmë të lirë, ndërtojmë të ardhme dhe vendosim për fatet tona, kjo është arritur falë luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe udhëheqësve të saj, historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet në një sallë gjyqi, sepse atë e kanë shkruar me gjakun e tyre dëshmorët dhe martirët saj, andaj sot kemi për detyrë të shprehim qartë mospajtimin tonë, nga ky Kuvend dhe mund ta bëjmë këtë duke miratuar deklaratën 'JO NË EMRIN TIM'.

Kosovar Ademi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar/a kolegë asambleistë, përfaqësues të Ekzekutivit të Komunës, përfaqësues të organizatave të dalura nga lufta dhe ju pranishëm, sot jemi mbledhur në këtë mbledhje të jashtëzakonshme me moton 'JO NË EMRIN TIM' dhe dua të filloj me një gjë shumë të qartë: qëndrimi ynë nuk ka filluar sot. Nuk ka filluar me këtë mbledhje dhe nuk ka ndryshuar për arsye të zhvillimeve të fundit. Që nga diskutimi dhe themelimi i Gjykatës Speciale, subjekti ynë politikë Lëvizja Vetëvendosje ka qenë kundër saj, e kemi thënë atëherë dhe po e themi edhe sot. Ne e kemi kundërshtuar, sepse besojmë se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk mund të shkëputet nga rrethanat në të cilat ka ndodhur. Nuk mund të shkëputet nga okupimi, nga dhuna dhe nga krimet e kryera ndaj popullit të Kosovës. Të jesh kundër Gjykatës Speciale, nuk do të thotë të jesh kundër drejtësisë. Ne jemi për drejtësi, por drejtësia duhet të jetë e drejtë, e paanshme dhe nuk duhet të përdoret për ta deformuar historinë. Ne nuk kemi ardhur sot këtu për të bërë politikë me fatin e askujt, jemi këtu për të mbrojtur një të vërtetë historike: Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte ushtria e një populli që luftonte për lirinë e vetë. Dhe pikërisht për këtë, motoja 'JO NË EMËR TIM' ka peshë, sepse unë nuk pranoj që në emrin tim, në emër të qytetarëve të Kosovës dhe në emër të një populli, që ka luftuar për liri, të ndërtohet një narrativë që e vendos luftën çlirimtare në të njëjtën peshore me krimet dhe politikën shtetërore të Serbisë. Ne mund të kemi dallime politike mes vete, mund të debatojmë për shumë çështje, por për historinë e luftës dhe për sakrificën e njerëzve tanë duhet të flasim me përgjegjësi. Prandaj, sot nuk po themi diçka të re, po e përsërisim atë që kemi thënë që nga fillimi dhe qëndrimi

ynë është i qartë: jo në emër tonë, jo ne emrin tim, jo në emër të atyre që luftuan për lirinë dhe jo në emër të popullit të Kosovës.

Laureat Gojnovci: Faleminderit i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuara organizata të dalura nga lufta, kolegë, zyrtarë të Kuvendit, përfaqësues të Ekzekutivit të Komunës, të nderuar/a qytetarë të Komunës së Fushë-Kosovës, sot nuk jemi këtu vetëm për të votuar një deklaratë, sot po vendosim që ky Kuvend, do ta thotë zërin e vet përballë një padrejtësie që prek jo vetëm krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por prek historinë dhe dinjitetin e një populli të tërë. Po flasim për krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por në të vërtetë po flasim për një luftë, që nuk filloi në Hagë dhe nuk përfundon me një aktgjykim. Ushtria Çlirimtare të Kosovës, nuk lindi në zyrat e politikës, ajo lindi nga vuajtjet e këtij populli, lindi nga dëbimet, dhuna, vrasjet dhe represioni që përjetoi populli shqiptarë në Kosovë dhe sot pas gjithë kësaj sakrifice, nuk mund të pranojmë që historia të shkruhet sikur Kosova të ishte agresori dhe jo viktima e një regjimi, që kishte mohuar lirinë dhe të drejtën tonë për të jetuar në vendin tonë. Sot para jush dua të jem shumë i qartë: respektimi i drejtësisë nuk do të thotë heshtje ndaj padrejtësisë, ne mund t'i respektojmë institucionet e drejtësisë dhe njëkohësisht t'i kundërshtojmë me një vendim që e konsiderojmë të padrejtë, sepse një aktgjykim mund të dënoj individë, por nuk mund të dënojë asnjë popull dhe nuk mund ta ndryshoj historinë e Kosovës, prandaj sot si anëtarë i këtij Kuvendi nuk dua që dikush pas shumë viteve të thotë, se kur u vu në pikëpyetje lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ne heshtëm, ne nuk do të heshtim dhe do të votojmë për një qëndrim dhe qëndrimi është i qartë 'JO NË EMRIN TIM DHE JO NË EMRIN TONË', të njëlloset sakrifica e atyre që luftuan për lirinë tonë, prandaj sot ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, do ta japim votën tonë pro kësaj deklarate të iniciuar nga kolegët e Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvend dhe këtë vote, nuk po e japim si anëtarë të Kuvendit të Komunës, nuk po e japim si asambleistë po e japim si qytetarë të Kosovës dhe në fund, jo në emrin tim të harrohen familjet që humbën më të dashurit e tyre, që ne sot të flasim lirëshëm në këtë foltore.

Gjelbrim Halili: Të nderuar/a përfaqësues të kategorive të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar kolegë asambleistë, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, drejtor të komunës, të dashur qytetarë të Fushë-Kosovës, aktgjykimi ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaqi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi, është një vendim që ne e kundërshtojmë dhe presim që drejtësia të vazhdojë, përmes procesit të apelit. Ne besojmë se kjo çështje është ngritur mbi një narrativë të ushqyer nga Serbia dhe fatëkeqësisht edhe nga njerëz që veprojnë lirëshëm në Kosovë, të lidhur me strukturat e UDB-së. Ky vendim nuk është në emër të popullit të Kosovës dhe as në emrin tim. Andaj, unë nuk dua ta zgjas shumë por dua të ju bëjë një thirrje: Ne mund të kemi dallime politike, mund të kemi bindje të ndryshme dhe të jemi në parti të ndryshme, por përballë luftës dhe sakrificës për liri duhet të jemi bashkë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës duhet të na bashkojë të gjithëve - pa dallim partie, bindje apo pozite, sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk luftoi për një parti, Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi për Kosovën. Lavdi dëshmorëve të Ushtria Çlirimtare e Kosovës! Nderim veteranëve dhe të gjithë atyre që sakrifikuan për lirinë e Kosovës.

Filloreta Tërnava: Të nderuar të pranishëm sot nga kjo foltore është e pamundur të flasim për historinë tonë pa e përmendur sakrificën e atyre, që morrën mbi vete barrën e luftës për lirinë e Kosovës. Sot flasim për çlirimtarët tanë, për njerëzit që u vunë në shërbim të vendit në ditët më të vështira të historisë tonë. Vendimet e fundit të Gjykatës Speciale në Hagë, kanë prekur thellë ndjenjat e secilit prej nesh, ne besojmë se e vërteta duhet të kërkohet gjithmonë, drejtësia duhet të respektohet dhe secili duhet të ketë të drejtë për një proces të drejtë. Nga kjo sallë le të dal një mesazh i qartë: Kosova nuk e harron sakrificën, Kosova nuk e harron lirinë, Kosova nuk e harron historinë e saj. Liria që gëzojmë sot është rezultat i një sakrifice të madhe, prandaj asnjë gjykatë nuk ka të drejtë të vendosë në emrin tim.

Arlinda Mekolli: Të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit të Komunës, të nderuar të pranishëm, sot jemi mbledhur për të shprehur vullnetin politikë dhe qytetarë të komunës sonë, përmes miratimit të kësaj deklarate, pas aktgjykimit të nxjerrë nga Dhomat e Specializuara në Hagë, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo gjykatë u imponua si një konstrukt juridik i padrejtë, me pasoja të rënda për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen shtetërore të Kosovës. Aktgjykimi i datës 16 shtator nuk mund ta tjetërsojë të vërtetën historike: lufta e popullit tonë për liri, ishte luftë e drejtë dhe çlirimtare. Mbështetja për çlirimtarët tanë nuk duhet të mbetet vetëm në nivel deklarativ, mbrojtja e vlerave të luftës kërkon përgjegjësi institucionale, jo vetëm brenda vendit, por edhe në arenën ndërkombëtare. Por, përtej deklaratave dhe qëndrimeve politike, kemi edhe një përgjegjësi konkrete ndaj atyre që bartën barrën e luftës dhe ndaj familjeve të tyre. Fatëkeqësisht edhe sot shumë prej kategorive të dala nga lufta, përballen me vështirësi sociale dhe ekonomike, ndërsa familje të tëra detyohen të kërkojnë një të ardhme më të mirë në emigrim. Kjo situatë duhet të shërbejë si një thirrje për ndërgjegjësim për të gjithë ne, është koha të pyesim vetën, si institucione dhe si shoqëri: A kemi bërë mjaftueshëm për ata që dhanë gjithë çka për lirinë që gëzojmë sot? Sepse kujtimi për luftën nuk duhet të jetë vetëm pjesë e fjalimeve dhe deklaratave tona, ai duhet të shëndrrohet në përgjegjësi, në mbështetje dhe në veprim konkret institucional.

Besarta Qadraku: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar/a kolegë asambleiste dhe ju të pranishëm, sot po flasim për një çështje që prek historinë, sakrificën dhe dinjitetin e popullit tonë. Lufta e Ushtria Çlirimtare e Kosovës është pjesë e historisë së Kosovës dhe sakrifica e atyre që luftuan për liri, nuk duhet harruar kurrë. Si asambleiste dhe përfaqësuese e qytetarëve të Fushë-Kosovës, e mbështesë këtë deklaratë dhe besoj se zëri ynë, duhet të jetë i qartë dhe dinjitoz, sepse liria që e gëzojmë sot është ndërtuar mbi sakrificën e shumë njerëzve dhe kujtimi për ta duhet të mbetet i gjallë. JO NË EMRIN TIM.

Hajredin Mjeku: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, Nënkryetar i Komunës, kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, sot në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, dua të shpreh respektin dhe mirënjohjen time për të gjithë ata që kontribuan për lirinë dhe çlirimin e vendit tonë. Liria që gëzojmë sot është rezultat i sakrificës, përkushtimit dhe qëndresës së shumë njerëzve. Prandaj, kujtimi dhe respekti për çlirimtarët duhet të mbetet pjesë e përherëshme e kujtesës sonë institucionale dhe qytetare. Në emër të respektit për sakrificën e tyre, e mbështesë këtë nismë dhe konsideroj, se është detyrë e jona që historinë dhe kontributin për liri ta ruajmë dhe ta përcjellim te brezat e rinjë.

Rrahim Tërnava: Përshëndetje Kryesues i Kuvendit të Komunës, organizata të dalura nga lufta, kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, falë liderëve të Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me luftë e gjak ka ardhë shteti i Kosovës, edhe ata e kanë sjellë. Në vitin 1999, ka nisur të shkatërrohet Jugosllavia si shtet, këtu në qytetin e Fushë Kosovës, pas shumë shpresave që humbën nga populli i Kosovës, ata lider e sjellën shpresën për popullin tonë, e formuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, pas vitit 1995 Kosova e ka humbur shpresën totalisht dhe njerëzit filluan të emigrojnë por doli Ushtria Çlirimtare e Kosovës me aksione të veta dhe filluan njerëzit, me pas shpresë që një ditë do të lirohet ky vend dhe ajo ndodhi. Njerëzit e parë që i morën armët janë ata që ndodhen në Hagë sot, ata na çliruan neve, por ne, a po i mbrojmë sot ata? Ne e kemi obligim t'i mbrojmë ata bashkë me secilin qytetarë. Një gjë që me gëzon në këto ditë, është që rinia po e përkrah Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, paska rini që do ta vazhdojnë rrugën e z. Hashim Thaqi dhe z. Kadri Veseli, kështu që ju lutem të angazhohemi të gjithë të flasim: JO NË EMRIN TIM! JO NË EMËRIN TONË! JO NË EMRIN E KOSOVËS!

Festim Pllana: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm, sot nuk dua të flas gjatë, sepse ka momente kur shumë fjalë, nuk e bëjnë një qëndrim më të fortë. Sot dua të them vetëm diçka 'JO NË EMËR TIM'. Jo në emër tim, nuk do të thotë të mohojmë drejtësinë, përkundrazi do të thotë të kërkojmë, që drejtësia mos të shkëputet nga e vërteta historike, nga rrethanat në të cilat u zhvillua lufta dhe nga dhimbja që ka përjetuar populli ynë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk është thjesht një emër në aktgjykim, për ne ajo është pjesë e një historie të jetuar, është kujtim i atyre që nuk u kthyen më në shtëpi, i familjeve që pritën, i njerëzve që sakrifikuan dhe i një populli që kërkonte të jetonte i lirë. Prandaj, nga kjo sallë sot nuk dua të flas vetëm si anëtarë i këtij Kuvendi, dua të flas si qytetarë i Kosovës dhe mesazhi im, është i thjeshtë: Historia jonë meriton të dëgjohet, sakrifica e atyre që dhanë gjithë çka për lirinë meriton të respektohet dhe zëri ynë meriton të dëgjohet, prandaj 'Jo në emrin tim, jo në emrin tonë'.

Kushtrim Mirena: Të nderuar/a të pranishëm, në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës të cilën e kemi thirrur në përkrahje të krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë nuk dua të flas vetëm si anëtarë i këtij Kuvendi. Sot dua të flas si një djalë, që vjen nga një familje në të cilën ka ndodhur një prej krimeve më të mëdha, të kryera nga regjimi serb në qytetin tonë dhe për më shumë se dy dekada për këto krime, nuk kemi parë drejtësi, nuk kemi parë që ndonjë prej atyre që i kryen këto krime, të akuzohet, e aq më pak të dënohet. E sot nga ana tjetër kemi një gjykatë që thirret në emër të popullit tonë dhe që merr vendime kundër krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke i dënuar në emër tonë. As ky dënim, e asnjë dënim nuk mund të vijë në emër të një familjeje që ka humbur 16 anëtarë nga krimet e regjimit serbë. Unë sot jam këtu, jo vetëm si asambleistë por si familjar i 16 viktimave, si qytetarë që beson se historia dhe sakrifica e popullit tone, nuk duhet të gjykohet. Në emër të familjes time, në emër të 16 viktimave të familjes Mirena të vrarë nga kriminelët serbë dhe në emër të kujtimit të tyre, kërkojë që krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të lirohen. Ata që luftuan për lirinë e këtij vendi, nuk mund të mbahen të dënuar në emër të popullit të Kosovës. Kërkojmë drejtësi dhe kërkojmë lirimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Daut Krasniqi: Përshëndetje i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe ju të pranishëm. Sot, nga kjo sallë e Kuvendit të Komunës së Fushë-

Kosovës, është e rëndësishme të ngremë zërin për një çështje që prek historinë, dinjitetin dhe ndërgjegjen e qytetarëve tanë. Bëhet fjalë për krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po përballen me një proces gjyqësor jashtë vendit. Respektimi i drejtësisë është parim themelor por drejtësia duhet të jetë e barabartë, e paanshme dhe e bazuar ne prova dhe fakte. Lufta e Kosovës është pjesë e historisë sonë të afërt, ajo u zhvillua në rrethana të jashtëzakonshme duke lënë pas shumë viktima, familje të dëbuara dhe plagë që ende nuk janë shëruar. Prandaj, është e rëndësishme që çdo proces që lidhet me atë periudhë të trajtohet me përgjegjësi, pa paragjykime dhe pa përgjithësime ndaj një populli të tërë. Nga ky Kuvend nuk kërkohet drejtësi e veçantë për askënd, kërkohet vetëm që drejtësia të jetë e drejtë. Fushë-Kosova, si pjesë e Republikës së Kosovës, e njeh dhe e respekton drejtësinë. Por, njëkohësisht e respekton edhe sakrificën e atyre që kontribuan në lirinë e vendit. Historia duhet të shkruhet mbi fakte, ndërsa drejtësia duhet të vendosë mbi prova. Në këtë Kuvend duhet të përcillet një mesazh i qartë: të kërkojmë drejtësi, të respektojmë institucionet dhe të mos lejojmë që historia e Kosovës, të gjykohet përmes paragjykimeve. Urojmë që e vërteta të dalë në dritë dhe që drejtësia të jetë e barabartë për të gjithë. Nderim për të gjithë të rënët për lirinë e Kosovës, respekt për viktimat e luftës dhe drejtësi për të gjithë 'JO NË EMRIN TIM'.

Rrahim Sogojeva: Të nderuar të pranishëm, shoqata të dalura nga lufta, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës dhe ju kolegë asambleistë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk luftoi vetëm për liri dhe pavarësi por edhe kundër dhunës, dëbimit dhe përpjekjeve për ta zhdukur popullin shqiptarë nga Kosova. Mos të harrojmë kurrë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi në një kohë kur tragjedia e Bosnjës dhe tmerret e luftërave në Sllloveni e Kroaci, ishin ende të freskëta. Për ne lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqëson një kapitull të rëndësishëm të historisë sonë dhe një përpjekje për mbrojtjen e popullit, dinjitetit dhe lirisë së Kosovës. Asnjë vendim gjyqësor nuk mund ta zhbëjë historinë dhe sakrificën e mijëra njerëzve, që dhanë gjithë çka për lirinë e vendit tonë. Mbrojtja e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kujtimi i sakrificës së saj, do të mbeten gjithmonë të rendësishme për ne dhe unë do jem gjithmonë në krah të çdo nisme që synon drejtësinë dhe respektimin e sakrificës së atyre që luftuan për Kosovës 'JO NË EMRIN TIM'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë z. Rrahim Sogojeva, meqenëse nuk ka të tjerë që dëshirojnë të marrin fjalën, e ftoj me shumë kënaqësi znj. Aida Alimi të na lexojë 'Deklaratën e përbashkët e cila do të hidhet në votim në Kuvendin e Komunës.

Aida Alimi: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, i nderuar Nënkryetar i Komunës, të nderuar/a përfaqësues të Ekzekutivit të Komunës, të nderuar ish-ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuara organizata të dalura nga lufta, të nderuar/a ju anëtarë dhe ju të pranishëm, sot ndihem shumë e privilegjuar që në emër të zgjedhurve të Komunës së Fushë- Kosovës, do të lexojë deklaratën 'JO NË EMËR TIM'.

DEKLARATË

- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, shpreh mospajtimin e tij, të thellë lidhur me Aktgjykimin e Shkallës së Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaci, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi.

- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, konsideron se përfundimi i këtij aktgjykimi dhe dënimet e shqiptuara ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës janë të padrejta dhe nuk pasqyrojnë në mënyrën të drejtë, rrethanat në të cilat u zhvillua lufta çlirimtare e popullit të Kosovës.

- Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga represioni, dhuna dhe krimet e regjimit serb. Qytetarët e Fushë-Kosovës, sikurse qytetarët anembanë Kosovës, i kanë përjetuar drejtëpërdrejtë pasojat e asaj periudhe dhe sakrificën e bërë për lirinë e vendit.

- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, kundërshton përfundimin e aktgjykimit përmes të cilit ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, u është atribuar përgjegjësi penale për krimet për të cilat janë shpallur fajtorë dhe vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë të padrejta. Në të njëjtën kohë, Kuvendi rikujton se ky është aktgjykim i shkallës së parë dhe se procesi juridik nuk ka përfunduar. Të dënuarit kanë të drejtë, që përfundimet faktike dhe juridike të aktgjykimit t'i kundërshtojnë përmes mjeteve juridike të parashikuara me ligj, në Gjykatën e Apelit, fazë në të cilën presim të triumfjë drejtësia dhe krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës t'i kthehen të lirë vendit të tyre.

- Veçanërisht i papranueshëm konsiderohet edhe shqiptimi i këtij aktgjykimi me formulimin dhe shprehjen 'Në emër të popullit të Kosovës'. Një formulim i tillë, nuk mund të interpretohet si shprehje e qëndrimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Andaj mbështetur në atë që u tha më lartë, tani Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, duke shprehur qëndrimin e tij, kundërshtues ndaj aktgjykimit të shkallës së parë dhe duke u solidarizuar me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, deklaron:

"JO NË EMRIN TIM"

Kjo është shprehje e mospajtimit me këtë aktgjykim dhe e të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaci, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë znj. Aida Alimi, tani pas diskutimeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, po e qesim në votim 'Deklaratën e lexuar nga ana e juaj.
U votua me unanimitet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës të pranishëm në mbledhje.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi:

DEKLARATËN EKUVENDIT TË KOMUNËS
"JO NË EMËR TIM"

- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, shpreh mospajtimin e tij, të thellë lidhur me Aktgjykimin e Shkallës së Parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaci, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi.
- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, konsideron se përfundimi i këtij aktgjykimi dhe dënimet e shqiptuara ndaj ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës janë të padrejta dhe nuk pasqyrojnë në mënyrën të drejtë, rrethanat në të cilat u zhvillua lufta çlirimtare e popullit të Kosovës.
- Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga represioni, dhuna dhe krimet e regjimit serb. Qytetarët e Fushë-Kosovës, sikurse qytetarët anembanë Kosovës, i kanë përjetuar drejtëpërdrejtë pasojat e asaj periudhe dhe sakrificën e bërë për lirinë e vendit.
- Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, kundërshton përfundimin e aktgjykimit përmes të cilit ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, u është atribuar përgjegjësi penale për krimet për të cilat janë shpallur fajtorë dhe vlerëson se dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë të padrejta. Në të njëjtën kohë, Kuvendi rikujton se ky është aktgjykim i shkallës së parë dhe se procesi juridik nuk ka përfunduar. Të dënuarit kanë të drejtë, që përfundimet faktike dhe juridike të aktgjykimit t'i kundërshtojnë përmes mjeteve juridike të parashikuara me ligj, në Gjykatën e Apelit, fazë në të cilën presim të triumfjë drejtësia dhe krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës t'i kthehen të lirë vendit të tyre.
- Veçanërisht i papranueshëm konsiderohet edhe shqiptimi i këtij aktgjykimi me formulimin dhe shprehjen 'Në emër të popullit të Kosovës'. Një formulim i tillë, nuk mund të interpretohet si shprehje e qëndrimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 10:40 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani